



Numri i dosjes: KSC-SC-2024-02

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës Supreme**

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse
Gjykatëse Kristinë van den Vajngart
Gjykatës Daniel Fransen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 29 korrik 2024

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: **Publik**

Vendim mbi Kërkesën e Salih Mustafës për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Prokurores së Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Salih Mustafës:

Julius von Bone

Mbrojtëses së Viktimave:

Ani Pues

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SUPREME i Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Paneli i Gjykatës Supreme” ose “Paneli”) duke vepruar në bazë të neneve 33(4), 53 dhe 162(2) të Kushtetutës,¹ neneve 3, 12, 14(1), 15(1), 16, 44(2), (3) dhe 48(6), (7), (8) dhe 64 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar² (“Ligji”) dhe rregullave 193 dhe 194(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”)³ ka marrë në shqyrtim Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Shtojcat Konfidenciale 1 dhe 2 në bazë të nenit 48 (6) deri (8) të Ligjit dhe rregullës 193 të Rregullores (“Kërkesa”).⁴

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses I lëshoi Aktgjykimin me të cilin e shpalli z. Salih Mustafa (“z. Mustafa”) fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e shpalli të pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor.⁵ Trupi Gjykses e dënoi z. Mustafa me 26 vjet burgim.⁶
2. Më 6 prill 2023, Trupi Gjykses I lëshoi Urdhrin për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, me të cilin e urdhëroi z. Mustafa t’u paguante 207.000 euro viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor si kompensim për dëmin e shkaktuar.⁷
3. Më 14 dhjetor 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit shqiptoi Aktgjykimin e Apelit

¹ Kushtetuta e Kosovës (me amendamentet I-XXIV), 5 gusht 2015.

² Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, nr. 05/L-053.

³ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, (miratuar më 17 mars 2017, rishikuar më 29 maj 2017, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020).

⁴ F00011, Kërkesë e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë në bazë të Nenit 48 (6) deri (8) të Ligjit dhe Rregullës 193 të Rregullores Ligjshmërisë me Shtojcat Konfidenciale 1 dhe 2, 14 mars 2024.

⁵ KSC-BC-2020-05/F00494, Aktgjykimi, 16 dhjetor 2022 (konfidencial), para. 831. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 24 janar 2023 dhe versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 qershor 2023.

⁶ Aktgjykimi, para. 831.

⁷ KSC-BC-2020-05/F00517, Urdhër për Zhdëmtim kundër Salih Mustafës me 4 Shtojca Rreptësisht Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 6 prill 2023 (konfidencial), para. 283. Versioni i redaktuar publik i Urdhrit për Zhdëmtim u dorëzua po atë ditë (KSC-BC-2020-05/F00517/RED) dhe versioni i korrigjuar i versionit të redaktuar publik u dorëzua më 14 prill 2023 (KSC-BC-2020-05/F00517/RED/COR).

me të cilin la në fuqi verdiktet e fajësisë së z. Mustafa për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, por miratoi pjesërisht apelin e z. Mustafa kundër dënimit të tij.⁸ Për këtë qëllim, Paneli i Gjykatës së Apelit e uli dënimin e z. Mustafa në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.⁹

4. Më 17 janar 2024, Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës Supreme për shqyrtimin, ndër të tjera, të çdo kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë që do të dorëzohej nga z. Mustafa.¹⁰

5. Më 14 mars 2024, z. Mustafa dorëzoi Kërkesën.

6. Më 12 prill 2024, Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi Përgjigjen e [Mbrojtëses së Viktimave] ndaj Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë ("Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave").¹¹

7. Më 15 prill 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Një Shtojcë Publike ("Përgjigjja e ZPS-së").¹²

8. Më 3 maj 2024, z. Mustafa dorëzoi Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë ("Kundërpërgjigjja ndaj ZPS-së")¹³ dhe Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Mbrojtëses së Viktimave për Mbrojtje të Ligjshmërisë ("Kundërpërgjigjja ndaj Mbrojtëses së Viktimave").¹⁴

⁸ KSC-CA-2023-02/F00038, Aktgjykimi i Apelit, 14 dhjetor 2023 (konfidencial), para. 484. Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit të Apelit u lëshua po atë ditë (KSC-CA-2023-02/F00038/RED).

⁹ Aktgjykimi i Apelit, para. 484.

¹⁰ F00003, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 17 janar 2024.

¹¹ F00013, Përgjigje e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 12 prill 2024.

¹² F00014, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë me Një Shtojcë Publike, 15 prill 2024.

¹³ F00016, Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 3 maj 2024.

¹⁴ F00017, Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së Mbrojtëses së Viktimave në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 3 maj 2024.

II. PRANUESHMËRIA

9. Paneli thekson se Aktgjykimi i Apelit është i formës së prerë dhe z. Mustafa e dorëzoi Kërkesën brenda afatit tremujor të përcaktuar në nenin 48(6) të Ligjit, pas shqiptimit të këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht, Kërkesa është e pranueshme në këtë aspekt dhe për rrjedhojë, Paneli do të vijojë me vlerësimin e secilës arsye të përfshirë në të.

10. Në qoftë se arsyet e dhënë nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë të standardit të shqyrtimit sikurse përcaktohet dhe shtjellohet në vijim,¹⁵ Paneli do ta hedhë poshtë atë arsye pa trajtuar themelësinë e saj.

III. STANDARDI I SHQYRTIMIT

11. Paneli rikujton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të karakterizohet si apel i shkallës së tretë, sikurse përcaktohet në nenin 47 të Ligjit, dhe në të nuk paraqiten arsye sipas nenit 48(1) - (5) të Ligjit. Ajo është mjet juridik i jashtëzakonshëm i përcaktuar në nenin 48(6) dhe (7) të Ligjit dhe rregullat 193 dhe 194 të Rregullores. Qëllimi i saj nuk është të krijojë një mundësi tjetër të përgjithshme për apel.¹⁶ Përkundrazi, dhe ngjashëm me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës,¹⁷ kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë bëhet vetëm për raste specifike të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore. Sikurse ka theksuar Gjykata Supreme e Kosovës:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si një ndër mjetet e jashtëzakonshme ligjore, është mjeti përjashtimor ligjor që synon të korrigjojë mundësisht zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Kërkesat e rrepta të pranueshmërisë synojnë të sigurojnë që ky mjet ligjor të mos përdoret si një shkallë e tretë e përgjithshme kundër të gjitha vendimeve në procedurën penale.¹⁸

¹⁵ *Shih më poshtë*, para. 11-24.

¹⁶ KSC-SC-2023-01/F00021, Vendim mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 18 shtator 2023 (“Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj”), para. 9; KSC-BC-2020-06, PL001/F00008, Vendim mbi Kërkesën e Kadri Veselit për Mbrojtje të Ligjshmërisë, 15 gusht 2022 (“Vendimi në lidhje me Veselin”), para. 21.

¹⁷ *Shih* nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës nr. 08/L-032, Gazetën Zyrtare nr. 24, 17 gusht 2022.

¹⁸ Gjykata Supreme e Kosovës, *S.S.*, Pml.Kzz 42/2017, Akgjykim, 10 maj 2017, para. 23.

12. Rrjedhimisht, ndaj arsyeve mbi të cilat bazohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë zbatohen kritere të rrepta të pranueshmërisë.
13. Në vlerësimin e secilës arsye, Paneli do të përcaktojë nëse ka shkelje të së drejtës penale të përfshirë në Ligj ose shkelje të konsiderueshme të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore.
14. Argumentet që mund të ishin paraqitur në mënyrë të arsyeshme para paneleve në shkallë të parë dhe të dytë, nuk mund të paraqiten *de novo* para Panelit të Gjykatës Supreme.¹⁹
15. Gjithashtu, arsyet mbi të cilat bazohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë që pretendojnë përcaktimin e gabuar dhe të paplotë të fakteve nuk janë në kompetencën e këtij Paneli dhe për rrjedhojë, janë të papranueshme.²⁰
16. Thjesht mospajtimi me vlerësimin e fakteve nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë, ose përsëritja fjalë për fjalë e parashtrimeve të bëra në apelet e mëparshme, pa trajtuar në masë të konsiderueshme vendimin e kundërshtuar apo aktgjykimin e formës së prerë dhe evidentuar gabimin apo shkeljen konkrete të pretenduar, janë po ashtu të pamjaftueshme për të përmbushur standardin e pranueshmërisë së këtyre arsyeve.²¹
17. Sa u përket shkeljeve sipas nenit 48(7) të Ligjit në bazë të të cilit kërkohet mbrojtje e ligjshmërisë, Dhoma e Gjykatës Supreme rikujton se ka përcaktuar më parë standardin e shqyrtimit të zbatueshëm për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë që kanë të bëjnë me *shkelje të konsiderueshme të procedurave* në aktgjykimet e formës së prerë.²² Paneli rikujton standardin e lartë të përcaktuar në nenin 48(7)(b) të Ligjit në

¹⁹ Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 10.

²⁰ Rregulla 193(3) e Rregullores. Shih gjithashtu Vendimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 10; Vendimin në lidhje me Veselin, para. 25.

²¹ Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 10; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 25.

²² Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 13.

lidhje me shkeljet e konsiderueshme të procedurave.²³ Konkretisht, Paneli vendosi se “shkelje të konsiderueshme” të procedurave ka kur kjo shkelje “ka ndikim juridikisht thelbësor në konstatimin gjyqësor”.²⁴ Pretendimi për shkelje të konsiderueshme të procedurave sikurse përcaktohet në Ligj dhe Rregullore duhet të vlerësohet rast pas rasti duke marrë parasysh rrethanat në të cilat bazohet secila kërkesë.²⁵

18. Gjithashtu, Paneli i Gjykatës Supreme rikujton se mund të konstatojë shkelje të konsiderueshme të procedurave në qoftë se, për shembull, Paneli i Gjykatës së Apelit: (i) nuk ka zbatuar një dispozitë të Ligjit ose Rregullores; (ii) ka zbatuar në mënyrë të gabuar Ligjin dhe/ose Rregulloren; ose (iii) ka shkelur të drejtat e Mbrojtjes në një mënyrë që ka ndikuar në dhënien e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë.²⁶

19. Trupi Gjykues gjithashtu përcaktoi standardin e shqyrtimit të zbatueshëm në lidhje me shkeljen apo shkeljet e së drejtës penale të përcaktuar në nenin 48(7)(a) të Ligjit.²⁷ Paneli konstatoi se ky nen nuk kërkon që shkelja e së drejtës penale të jetë “e konsiderueshme”.²⁸

20. Gjithashtu, Paneli vëren listën shteruese të shkeljeve të së drejtës penale të përcaktuar në nenin 385(1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës dhe gjykon se shkeljet e së drejtës penale kufizohen vetëm në shkeljet e përmendura aty. Konkretisht, këto shkelje ndodhin kur: (i) vepra për të cilin i akuzuari ndiqet penalisht nuk është vepër penale; (ii) ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale dhe, sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë; (iii) ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale; (iv) lidhur me veprën e gjykuar

²³ Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 14; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 23.

²⁴ Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 14; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 23.

²⁵ *Shih gjithashtu* Gjykata Supreme e Kosovës, NV, Pml.Kzz 91/2015, Aktgjykim, 14 maj 2015, para. 4, 10-12; AM, Pml.Kzz 84/2015, Aktgjykim, 12 maj 2015, f. 3-4; M.I., Pml.Kzz 26/2015, Aktgjykim, 18 mars 2015, f. 5-7.

²⁶ Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 14; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 24.

²⁷ Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 17.

²⁸ Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 17.

penale është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet; (v) në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim, gjykata ka tejkualuar kompetencat ligjore; ose (vi) janë shkelur dispozitat për sa i përket llogaritjes së periudhës së paraburgimit, arrestit shtëpiak, çdo periudhë e heqjes së lirisë si dhe të dënimit të kryer më parë lidhur me veprën penale objekt i procedurës penale.²⁹

21. Paneli thekson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të bazohet edhe në nenin 48(8) të Ligjit, ku përcaktohet se kërkesa për mjete juridike të jashtëzakonshme mund të paraqitet edhe në bazë të të drejtave sipas këtij ligji, të cilat gjithashtu janë të mbrojtura me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ"). Paneli gjykon se çdo shkelje e të drejtave sipas Ligjit, të cilat mbrohen edhe nga KEDNJ-ja, duhet të përmbushë të njëjtin standard shqyrtimi të përcaktuar më lart.³⁰

22. Gjithashtu, Paneli ka konstatuar se pala që kërkon mbrojtje të ligjshmërisë duhet të evidentojë qartë shkeljen e pretenduar të ligjit, ta faktojë atë dhe, në rastin e shkeljes së procedurave, të tregojë se si ka ndikuar thelbësisht në aktgjykimin e kundërshtuar.³¹

23. Së fundi, Paneli rikujton rregullën 194(1) të Rregullores, në të cilën përcaktohet se nëse Paneli i Gjykatës Supreme miraton kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, në varësi të llojit të shkeljes, paneli:

- (a) modifikon aktvendimin ose aktgjykimin e kundërshtuar; ose
- (b) anulon tërësisht ose pjesërisht aktvendimin ose aktgjykimin e kundërshtuar dhe ia kthen çështjen për vendim të ri ose rigjykim panelit kompetent; ose
- (c) kufizohet vetëm në konfirmimin e ekzistencës së një shkeljeje ligjore.

²⁹ Neni 385(1)(1.1-1.6) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. *Shih gjithashtu* Vendimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 17.

³⁰ *Shih* Vendimin në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 18; Vendimin në lidhje me Veselin, para. 33.

³¹ Vendimi në Çështjen Gucati dhe Haradinaj, para. 19; Vendimi në lidhje me Veselin, para. 23.

24. Pasi ka rikujtuar standardin e shqyrtimit, Paneli i Gjykatës Supreme do të trajtojë disa aspekte paraprake dhe në vijimësi do të trajtojë arsyet mbi të cilat bazohet Kërkesa.

IV. ÇËSHTJE PARAPRAKE

25. Fillimisht Paneli do të trajtojë nëse viktimat pjesëmarrëse kanë të drejtë për të bërë parashtrime në lidhje me Kërkesën.

26. Z. Mustafa kundërshton të drejtën e viktimave pjesëmarrëse për t'i paraqitur parashtrime Panelit. Sipas tij, Mbrojtësja e Viktimave nuk ka demonstruar se si diskutimet ligjore të paraqitura në Kërkesë ndikojnë në të drejtat e viktimave dhe, për rrjedhojë, nuk ka të drejtë të dorëzojë parashtrime në lidhje me to.³² Sipas z. Mustafa, për këtë arsye Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave ndaj Kërkesës duhet të hidhet poshtë.³³

27. Paneli rikujton se Kërkesa që ka marrë nuk përbën apel të shkallës së tretë, por është mjet juridik i jashtëzakonshëm në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Paneli vëren se Ligji dhe Rregullorja nuk përmendin nëse Mbrojtësja e Viktimave mund t'i përgjigjet kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Megjithatë, Paneli është i mendimit se viktimat të cilave u është miratuar pjesëmarrja në procese para Dhomave të Specializuara, *nëpërmjet* Mbrojtësit të Viktimave, mund t'u përgjigjen parashtrimeve të palëve, përfshirë kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundrejt aktgjykimit të apelit, kur ndikohen interesat e tyre personale dhe përgjigjja e tyre nuk cenon ose nuk bie ndesh me të drejtat e të akuzuarit.³⁴ Këto parashtrime kufizohen në arsyet e paraqitura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe duhet të paraqesin se si ndikohen nga kjo interesat personale të viktimave pjesëmarrëse. Duke pasur parasysh këto kritere, Paneli do të përcaktojë *rast pas rasti* nëse do t'i shqyrtojë

³² Kundërpërgjigjja ndaj Mbrojtëses së Viktimave, para. 10-14.

³³ Kundërpërgjigjja ndaj Mbrojtëses së Viktimave, para. 14.

³⁴ *Shih* nenin 22(3) të Ligjit.

parashtrimet e dorëzuara nga Mbrojtësja e Viktimave.

28. Mbrojtësja e Viktimave pretendon se deri më tani viktimat pjesëmarrëse nuk kanë bërë parashtrime në lidhje me dispozitat ligjore përkatëse për sa i përket dënimit, pasi “interesat e tyre nuk ndikohen drejtpërdrejt” dhe ata “e bazuan besimin e tyre në panelin përkatës të gjykatësve për të vendosur drejtësinë dhe për të shpallur dënimin e duhur për krimet e kryera nga [z.] Mustafa”.³⁵ Sipas Mbrojtëses së Viktimave, viktimat pjesëmarrëse ishin në përgjithësi të kënaqura me dënimin e dhënë nga Trupi Gjykues dhe të zhgënjyera nga ulja e tij prej Panelit të Apelit.³⁶ Rrjedhimisht, Mbrojtësja e Viktimave pretendon se është në interesin e viktimave për të siguruar që dënimi të pasqyrojë peshën e krimeve dhe dëmin që pësuan”.³⁷ Mbrojtësja e Viktimave argumenton se ato gjithashtu duhet të kenë mundësinë të bëjnë parashtrime mbi argumentet lidhur me shpalljen e z. Mustafa fajtor për krimin e luftës të vrasjes së paligjshme, pasi anulimi i atij verdikti “ndikon drejtpërdrejt në interesat e viktimave të tërthorta pjesëmarrëse në këtë çështje”.³⁸

29. Paneli vëren se Mbrojtësja e Viktimave bën parashtrime në lidhje me Arsyet 1 deri në 4 të Kërkesës.³⁹ Kur bëhet fjalë për Arsyet 1 deri në 3, të cilat kanë lidhje me dënimin, Paneli pranon se viktimat pjesëmarrëse mund të kenë interes personal në vendimin e këtij Paneli mbi kundërshtimin e z. Mustafa ndaj kohëzgjatjes së dënimit me burgim që iu dha. Përcaktimi nëse interesat personale të viktimave mund të ndikohen, do të varet nga lloji i kundërshtimeve të paraqitura dhe nëse ato janë vetëm të karakterit ligjor.

30. Paneli mban parasysh se Mbrojtësja e Viktimave nuk ka paraqitur më parë parashtrime mbi aspektet ligjore që lidhen me dënimin me burgim të z. Mustafa.

³⁵ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 4.

³⁶ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 5.

³⁷ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 5.

³⁸ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 13.

³⁹ *Shih* Përgjigjen e Mbrojtëses së Viktimave, para. 4-18.

Gjithsesi, Paneli është bindur se Mbrojtësja e Viktimave ka treguar se interesat personale të viktimave pjesëmarrëse mund të ndikohen nga konstatimi i mundshëm i Panelit mbi arsyet e dënimit të z. Mustafa. Gjithashtu, Paneli vëren se ZPS-ja iu është përgjigjur në mënyrë të ngjashme Arsyeve 1 deri në 3 të Kërkesës dhe për rrjedhojë, është bindur se pjesëmarrja e viktimave mbi këtë bazë as nuk cenon, as nuk bie ndesh me të drejtat e z. Mustafa. Rrjedhimisht, Paneli do të shqyrtojë parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave në lidhje me Arsyet 1 deri në 3.

31. Sa i përket Arsyet 4, që ka lidhje me shpalljen fajtor të z. Mustafa për vrasje të paligjshme si krim lufte, Paneli vë në dukje se Mbrojtësja e Viktimave argumenton se çdo ndryshim i mundshëm i kësaj fajësie nga Paneli do të ndikonte drejtpërdrejt në interesat personale të viktimave të tërthorta pjesëmarrëse në këtë çështje.⁴⁰

32. Paneli është bindur se parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave lidhur me këtë arsye ndikojnë në interesat personale të viktimave pjesëmarrëse, ndër të tjera në të drejtën e tyre për njohjen e dëmit që pësuan dhe, si pjesë e kësaj të drejte, të drejtën e tyre për t'u zhdëmtuar për dëmin e pësuar si pasojë e krimit për të cilin z. Mustafa u shpall fajtor. Në fakt, çdo vendim i marrë nga Paneli në përputhje me rregullën 194 të Rregullores mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në interesat personale të viktimave pjesëmarrëse. Gjithashtu, Paneli është bindur se, për këto arsye, pjesëmarrja e viktimave as nuk cenon, as nuk bie ndesh me të drejtat e z. Mustafa. Rrjedhimisht, Paneli do të shqyrtojë parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave në lidhje me Arsyen 4.

33. Pasi sqaroi të drejtën e viktimave pjesëmarrëse për t'iu përgjigjur Kërkesës nëpërmjet parashtrimeve, Paneli do të shqyrtojë arsyet e paraqitura nga z. Mustafa.

V. DISKUTIM

34. Paneli vë në dukje se z. Mustafa paraqet pretendime për shkelje të konsiderueshme të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore, si dhe për

⁴⁰ *Shih* Përgjigjen e Mbrojtëses së Viktimave, para. 13.

shkelje të së drejtës penale në lidhje me Aktgjykimin e Apelit. Fillimisht, Paneli do të shqyrtojë Arsyen 5, pasi ngre probleme që kanë të bëjnë me drejtësinë themelore të procesit. Më pas Paneli do të shqyrtojë Arsyen 4, që lidhet me kundërshtimet ndaj shpalljes fajtor të z. Mustafa për vrasje të paligjshme si krim lufte, për shkak se çdo vendim në lidhje me këtë Arsyë mund të ndikojë në shqyrtimin prej Panelit të Arsyeve 1 deri në 3, që lidhen me kundërshtimet ndaj kohëzgjatjes së dënimit me burgim të z. Mustafa. Rrjedhimisht, vlerësimi i Arsyeve 1 deri në 3 do të kryhet në fund. Arsyet 1 deri në 3 do të shqyrtohen së bashku, pasi çdo vendim se cili legjislacion i Kosovës do të merret parasysh lidhur me parimin *lex mitior* mund të ketë ndikim në vlerësimin e dënimit të z. Mustafa.

A. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË SË DREJTËS PËR GJYKIM TË DREJTË (ARSYEJA 5)

35. Paneli vëren se argumentet e parashtruara në Arsyen 5 në lidhje me përkthimin e Aktgjykimit të Apelit nuk mund të karakterizohen si shkelje e së drejtës penale të përfshirë në Ligj, ose si shkelje e konsiderueshme e procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore, sikurse përcaktohet në nenin 48(7) të Ligjit, nga paneli i shkallës së parë ose nga paneli i shkallës së dytë. Në vend të kësaj, argumentet e Mustafës në lidhje me kohën që mori përkthimi në shqipe i Aktgjykimit të Apelit duhen kuptuar si pretendime për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë në procesin para Panelit të Gjykatës Supreme. Faktikisht, Paneli mendon se të drejtat që i takojnë një të akuzuari për gjykim të drejtë përfshijnë procesin para Panelit të Gjykatës Supreme dhe, për rrjedhojë, është detyrë e këtij Paneli të sigurojë që të drejtat e z. Mustafa të respektohen në këtë kontekst.

1. Parashtrimet

36. Z. Mustafa parashtron se janë shkelur të drejtat që i takojnë sipas nenit 6(3)(a) dhe (b) të KEDNJ-së, si edhe neneve 22(2), 30(1) dhe (3) të Kushtetutës për ta marrë

Aktgjykimin e Apelit në një gjuhë që ai e kupton në “një fazë më të hershme”.⁴¹ Z. Mustafa pretendon se nuk iu dha kohë e mjaftueshme për t’u përgatitur për mbrojtjen e tij dhe për t’u informuar menjëherë, në një gjuhë që e kupton, për llojin dhe shkakun e verdikteve të fajësisë të shqiptuara kundër tij.⁴² Z. Mustafa argumenton se kjo shkelje u shkaktua nga caktimi i një mbrojtësi të ri për përgatitjen e Kërkesës.⁴³

37. ZPS-ja argumenton se z. Mustafa nuk arrin të vërtetojë shkelje të procedurës dhe pretendon se kërkesa e z. Mustafa për mjet juridik sipas rregullës 194 të Rregullores duhet të hidhet poshtë menjëherë.⁴⁴ ZPS-ja parashtron se, edhe sikur Paneli ta merrte parasysh këtë arsye, Aktgjykimi i Apelit u lëshua në anglishte, që ishte gjuha e punës e procesit të apelit.⁴⁵ Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se versioni i parë i përkthimit të Aktgjykimit të Apelit në shqipe iu dha z. Mustafa më 12 shkurt 2024, më shumë se një muaj para dorëzimit të Kërkesës dhe se atij iu vu në dispozicion një përkthyes për ta ndihmuar që të kuptonte Aktgjykimin e Apelit.⁴⁶ ZPS-ja pretendon se z. Mustafa nuk ka demonstruar se u dëmtua dhe se, sidoqoftë, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë përqendrohen vetëm në aspekte ligjore, “që janë kryesisht detyrë e Mbrojtjes”.⁴⁷

38. Z. Mustafa kundërpërgjigjet se përkthyesve profesionistë iu deshën pothuajse dy muaj për të përkthyer Aktgjykimin e Apelit dhe për rrjedhojë, nuk është e arsyeshme të pritet që një përkthyes ta ndihmojë z. Mustafa për të kuptuar plotësisht një dokument me vëllimin e Aktgjykimit të Apelit përpara dorëzimit të përkthimit zyrtar.⁴⁸

⁴¹ Kërkesa, para. 112. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 111, 114-115; Kundërpërgjigjja ndaj ZPS-së, para. 47, 49.

⁴² Kërkesa, para. 112. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, para. 50-54.

⁴³ Kërkesa, para. 113.

⁴⁴ Përgjigjja e ZPS-së, para. 36.

⁴⁵ Përgjigjja e ZPS-së, para. 37.

⁴⁶ Përgjigjja e ZPS-së, para. 37-38.

⁴⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 38.

⁴⁸ Kundërpërgjigjja ndaj ZPS-së, para. 50-51.

2. Vlerësimi i Panelit

39. Paneli vë në dukje se rregulla 183(4) e Rregullores përcakton se një kopje e Aktgjykimit të Apelit i jepet të akuzuarit “sa më shpejt që të jetë e mundshme” në një gjuhë që i akuzuari e kupton dhe flet. Gjithashtu, Paneli rikujton se Aktgjykimi i Apelit u lëshua në anglishte, që është gjuha e punës në këtë çështje gjyqësore, më 14 dhjetor 2023.⁴⁹

40. Në lidhje me drejtësinë e procesit, Paneli është i vetëdijshëm se ka pasur njëfarë humbje kohe në përgatitjen e Kërkesës nga ndërrimi i mbrojtësit, procedurat në lidhje me këtë ndërrim dhe riemërimi i z. von Bone si mbrojtës të z. Mustafa.⁵⁰ Gjithashtu, Paneli mban parasysh konstatimin e vet se Ligji ndalon ndryshimin e afatit për dorëzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.⁵¹ Gjithsesi, Paneli thekson se z. Mustafa e mori përkthimin e paredaktuar të Aktgjykimit të Apelit më 12 shkurt 2024, një muaj para dorëzimit të kërkesës së tij për mbrojtje të ligjshmërisë.⁵² Para kësaj kohe z. Mustafa u ndihmua nga një përkthyes për të kuptuar Aktgjykimin e Apelit.⁵³ Paneli gjithashtu vë në dukje se z. von Bone e nje mirë çështjen gjyqësore të z. Mustafa pasi e ka përfaqësuar z. Mustafa gjatë gjithë fazës së gjykimit dhe apelit.

41. Paneli vëren se z. von Bone nuk paraqiti parashtrime që sugjeronin se ai nuk ishte në gjendje t'i parashtronte të gjitha argumentet ose arsyet që synonte t'i përfshinte në Kërkesë për shkak të riemërimit të tij në një fazë të mëvonshme të procesit. Në vend të kësaj, argumentet e z. von Bone fokusohen në marrjen e përkthimit në shqipe të Aktgjykimit të Apelit nga z. Mustafa. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se të drejtat e z. Mustafa janë respektuar gjatë të gjithë kohës dhe se mbrojtësi

⁴⁹ KSC-BC-2020-05/F00032, Vendim për Gjuhën e Punës, 8 tetor 2020, para. 31. *Shih gjithashtu* KSC-CA-2023-02/F00003, Vendim për Gjuhën e Punës, 9 janar 2023, para. 5.

⁵⁰ *Shih* F00008, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë në lidhje me Konflikt Interesash të Mbrojtësit, 25 janar 2024; F00010, Njoftim i Caktimit të Mbrojtësit Kujdestar për Salih Mustafën me Një Shtojcë Konfidenciale, 29 janar 2024 (“Njoftimi i Caktimit të Mbrojtësit Kujdestar”).

⁵¹ F00009, Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje të Afatit, 25 janar 2024.

⁵² *Shih* Kërkesën, para. 111.

⁵³ *Shih* Përgjigjen e ZPS-së, para. 37.

vazhdoi ta përfaqësonte atë në përgatitjen e Kërkesës.⁵⁴

42. Çka është e rëndësishme, Paneli rikujton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është tërësisht e llojit ligjor, që përfshihet kryesisht në përgjegjësinë e mbrojtësit. Rrjedhimisht, z. von Bone pati mundësinë ta këshillonte z. Mustafa mbi arsyet e mundshme për parashtrimin e një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pa përkthimin zyrtar të Aktgjyqimit të Apelit.⁵⁵

43. Paneli pranon se si pasojë e zgjedhjeve të bëra nga z. Mustafa, z. von Bone pati më pak kohë për përgatitjen e Kërkesës për shkak të riemërimit të tij në një fazë të mëvonshme të procesit. Megjithatë, Paneli mban parasysh se standardi i rreptë i pranueshmërisë që aplikohet për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kufizon llojin e arsyeve që mund të paraqiten. Gjithashtu, Paneli rikujton se të drejtat e z. Mustafa janë respektuar gjatë të gjithë kohës dhe se mbrojtësi vazhdoi ta përfaqësojë në përgatitjen e Kërkesës.⁵⁶ Paneli vëren se z. von Bone nuk paraqiti argumente se ai nuk ishte në gjendje t'i parashtronte të gjitha argumentet ose arsyet që synonte t'i përfshinte në Kërkesë për shkak të riemërimit të tij në një fazë të mëvonshme të procesit. Në vend të kësaj, argumentet e z. von Bone fokusohen në marrjen e përkthimit në shqipe të Aktgjyqimit të Apelit nga z. Mustafa.

44. Bazuar në sa më lart, Paneli, ndonëse e njeh rëndësinë e të drejtës së z. Mustafa për ta marrë Aktgjykimin e Apelit në një gjuhë që e kupton, mendon se drejtësia e procesit para këtij Paneli nuk është cenuar nga koha e marrjes së përkthimit në shqipe të Aktgjyqimit të Apelit nga z. Mustafa. Rrjedhimisht, Paneli hedh poshtë Arsyen 5 të

⁵⁴ *Shih*, p.sh. KSC-CA-2023-02/F00041, Njoftim i Miratimit të Mbrojtësit për Salih Mustafën me Një Shtojcë Konfidenciale, 11 janar 2024 ("Njoftimi i Miratimit të Mbrojtësit"); F00004, Informacion Shtesë në lidhje me Njoftimin e Miratimit të Mbrojtësit për Salih Mustafën me dy Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte*, 18 janar 2024 ("Informacion Shtesë në lidhje me Njoftimin e Miratimit të Mbrojtësit").

⁵⁵ *Shih* KSC-CA-2022-01/F00005 Vendim mbi Kërkesën e Haradinajt për Qartësim të Afateve të Apelit, 25 maj 2022, para. 4, dhe citimet në të.

⁵⁶ *Shih*, p.sh. Njoftimin e Miratimit të Mbrojtësit; Informacionin Shtesë në lidhje me Njoftimin e Miratimit të Mbrojtësit; Njoftimin e Caktimit të Mbrojtësit Kujdestar.

z. Mustafa.

B. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 14(1)(C) TË LIGJIT DHE RREGULLAVE 159(3) DHE 183(3) TË RREGULLORES (ARSYEJA 4)

1. Parashtrimet

45. Z. Mustafa parashtron se “vrasja e paligjshme, sikurse përcaktohet në nenin 14(1)(c) [të Ligjit] nuk u gjykua si duhej në këtë çështje gjyqësore”,⁵⁷ që përbën “shkelje të konsiderueshme të Rregullores”.⁵⁸ Konkretisht, z. Mustafa pretendon se si Aktgjykimi dhe Aktgjykimi i Apelit nuk dhanë “arsye të qarta dhe përputhëse” ose “nuk diskutuan prova thelbësore” sikurse kërkohet në rregullat 159(3), 164(2) dhe 183(3) të Rregullores.⁵⁹ Për këtë qëllim, z. Mustafa argumenton se gjykatat e shkallëve më të ulta nuk vërtetuan siç duhet elementet e nevojshme në mbështetje të konstatimit në lidhje me përgjegjësinë e tij duke marrë parasysh ndërhyrjen e një pale të tretë.⁶⁰

46. ZPS-ja pretendon se z. Mustafa parashtron argumente që janë kryesisht faktike, të cilat janë të papranueshme sikurse përcaktohet në standardin e shqyrtimit që zbatohet për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë.⁶¹ Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se argumentet e z. Mustafa në lidhje me mungesën e arsytimit paraqiten për herë të parë para këtij Paneli dhe, për rrjedhojë, po ashtu duhet të hidhen poshtë.⁶² ZPS-ja parashtron se, edhe në qoftë se merren parasysh në lidhje me themelësinë, argumentet e z. Mustafa lidhur me mungesën e arsytimit duhet të hidhen poshtë, për shkak se pati arsyetim të mjaftueshëm si në Aktgjykim ashtu edhe në Aktgjykimin e Apelit.⁶³

47. Mbrojtësja e Viktimave parashtron se z. Mustafa nuk sqaron nëse pretendimet e tij mbi këtë bazë janë procedurale apo materiale dhe argumenton se, sidoqoftë,

⁵⁷ Kërkesa, para. 88.

⁵⁸ Kërkesa, para. 89.

⁵⁹ Kërkesa, para. 90.

⁶⁰ Kërkesa, para. 91-103, 105-109. *Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së*, para. 42.

⁶¹ Përgjigja e ZPS-së, para. 28-29, 35.

⁶² Përgjigja e ZPS-së, para. 30.

⁶³ Përgjigja e ZPS-së, para. 31-34.

Aktgjykimi i Apelit përmban diskutim dhe arsyetim të gjerë në lidhje me parimin *novus actus interveniens*.⁶⁴ Mbrojtësja e Viktimave parashtron se duket se kjo është përpjekje e z. Mustafa "për të çuar në rishqyrtim të provave të dëgjua gjatë fazës së gjyqimit" dhe rrjedhimisht, kjo arsye duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.⁶⁵

48. Z. Mustafa kundërpërgjigjet se ka kundërshtuar tri elementet e reja të paraqitura nga Paneli i Apelit, që nuk u diskutuan në Aktgjykim.⁶⁶ Sipas z. Mustafa, për ta shpallur dikë fajtor për një krim sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, konstatimi duhet të arsyetohet në përputhje me rregullën 159(3) të Rregullores.⁶⁷ Z. Mustafa parashtron se mungesa e trajtimit të qartë prej Trupit Gjykses i këtyre tri elementeve është shkelje e konsiderueshme e procedurave.⁶⁸

2. Vlerësimi i Panelit

49. Paneli vëren se z. Mustafa i referohet nenit 14(1)(c) të Ligjit dhe më pas argumenton se ka pasur shkelje të konsiderueshme të procedurave duke pasur parasysh se në Aktgjykimin dhe Aktgjykimin e Apelit nuk pati arsyetim të mjaftueshëm.⁶⁹ Paneli vë në dukje se, për të mbështetur pretendimin për shkelje të konsiderueshme të procedurave, z. Mustafa mbështetet kryesisht në konstatimet faktike të nxjerra nga Trupi Gjykses dhe/ose Paneli i Apelit, që ai pretendon se nuk i mbështesin konstatimet ligjore të bëra.

50. Fillimisht, Paneli vëren se z. Mustafa kundërshton konstatimet faktike të Trupit Gjykses dhe analizën e mëpasshme të Panelit të Apelit. Konkretisht, argumentet e z. Mustafa përqendrohen në supozimin se në qoftë se Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit do të kishin bërë konstatim për ndërhyrje të palës së tretë, forcave serbe, dhe për origjinën e plumbit apo plumbave të gjetur në viktimën e vrasjes së paligjshme, kjo do

⁶⁴ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 14-17.

⁶⁵ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 18.

⁶⁶ Kundërpërgjigjja ndaj ZPS-së, para. 43-45.

⁶⁷ Kundërpërgjigjja ndaj ZPS-së, para. 45.

⁶⁸ Kundërpërgjigjja ndaj ZPS-së, para. 45.

⁶⁹ Kërkesa, para. 90.

të kishte çuar në një përfundim të ndryshëm në lidhje me përgjegjësinë e tij penale për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme.⁷⁰

51. Në këtë aspekt, Paneli thekson se Trupi Gjykses arriti në përfundimin se vdekja e viktimës së vrasjes së paligjshme ishte pasojë a kombinimit të: (i) keqtrajtimit të rëndë të tij nga anëtarët e BIA-s që e mbajtën të ndaluar; (ii) mosdhënies së ndihmës mjekësore nga anëtarët e BIA-s; dhe (iii) plagëve me armë zjarri të shkaktuara nga plumbi apo plumbat, “në lidhje me të cilat Trupi Gjykses ka konstatuar se ekziston dyshim i arsyeshëm nëse ato mund t’u atribuohen anëtarëve të BIA-s, apo forcave serbe”.⁷¹ Gjithsesi, Trupi Gjykses arriti në përfundimin se, pavarësisht nëse viktima e vrasjes së paligjshme u godit nga një ose më shumë plumba serbë, sjellja e përmendur në pikat (i) dhe (ii) më lart shkaktoi në masë të konsiderueshme vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme dhe se këto shkaqe i atribuohen z. Mustafa.⁷²

52. Më pas Paneli i Apelit përcaktoi se Trupi Gjykses e kishte zbatuar drejt “kriterin e kontributit të konsiderueshëm”, të cilin z. Mustafa në thelb nuk e ka kundërshtuar.⁷³ Megjithatë, Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykses duhej të kishte trajtuar më qartësisht nëse të shtënat me armë zjarri përbënin ndërhyrje nga pala e tretë që ndërpreu zinxhirin e shkakësisë.⁷⁴ Për këtë arsye, Paneli i Apelit kreu një

⁷⁰ *Shih* Kërkesën, para. 96 (“megjithatë, ky supozim (rreziku për jetën e viktimës së vrasjes së paligjshme) nuk u mbështet nga asnjë provë, as nga ndonjë arsyetim pse afrimi i trupave serbe përbënte rrezik për jetën. Ky është supozim i pambështetur, pa asnjë arsyetim se pse, ose çfarë lloj rreziku kishte viktima nga avancimi i forcave serbe”), 97 (“As Trupi Gjykses, as Paneli i Apelit nuk përcaktuan se në çfarë kohe u afruan faktikisht forcat serbe vendit ku ndodhej viktima e vrasjes së paligjshme. Në fakt, nuk u konstatua nëse forcat serbe shkuan në vendin ku ndodhej viktima e vrasjes së paligjshme, ose nëse forcat serbe qëndruan shumë larg kësaj vendndodhje”), 98 (“Edhe në qoftë se forcat serbe avancuan në një moment të caktuar dhe duke supozuar se të shtënat me armë zjarri nga forcat serbe përbëjnë ndërhyrje nga pala e tretë, është e rëndësishme të dihet se në çfarë kohe ndodhi kjo për të vlerësuar nëse ka ndërprerje të zinxhirit të shkakësisë”), 99 (“Meqë pretendohet se viktima e vrasjes së paligjshme ishte pothuajse i vdekur, nuk mund të përcaktohet nëse forcat serbe – në qoftë se me të vërtetë shkuan në atë vendndodhje – nuk do ta ndihmonin viktimën, ose bënë diçka me të. Duket se ai ishte i paarmatosur, kështu që pse do ta vrisnin? Ose pse ishin serbët ata që e vranë? Mbetet thjesht e papërcaktuar, pasi nuk u bënë konstatime në lidhje me këtë”).

⁷¹ Aktgjykimi, para. 689.

⁷² Aktgjykimi, para. 689.

⁷³ Aktgjykimi i Apelit, para. 344.

⁷⁴ *Shih* Aktgjykimin e Apelit, para. 348.

analizë të gjatë për të vërtetuar nëse, në qoftë se të shtënat me armë zjarri do të kishin ardhur nga forcat serbe, z. Mustafa do të ishte liruar nga përgjegjësia e tij për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme.⁷⁵

53. Konkretisht, Paneli i Apelit konstatoi, nëpërmjet analizës krahasuese të disa juridiksioneve, se “për të pasur pasoja për zinxhirin e shkakësisë të nisur nga sjellja fillestare, ngjarja e re ndërhyrëse nuk duhet të jetë e parashikueshme, ose nuk duhet të jetë pjesë e sferës fillestare të rrezikut që i përket të akuzuarit dhe duhet të krijojë rrezik krejtësisht të ri që është aq i fuqishëm sa që ta bëjë rrezikun fillestar të paqenësishëm”.⁷⁶ Paneli i Apelit arriti në përfundimin se konstatimi i Trupit Gjykses mbështeti përfundimin se sjellja që i atribuohet z. Mustafa ishte e parashikueshme, se ajo ishte pjesë e sferës fillestare të rrezikut dhe se rreziku i paraqitur nga afrimi i forcave serbe nuk ishte aq i fuqishëm sa që ta bënte të paqenësishëm rrezikun fillestar të shkaktuar nga z. Mustafa.⁷⁷ Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstatoi se ishte përmbushur kriteri i veprimit të fajshëm të vrasjes së paligjshme.⁷⁸ Gjithashtu, Paneli i Apelit vuri në dukje se z. Mustafa duket se ngatërron shkakun mjekësor të vdekjes me shkakësinë juridike.⁷⁹

54. Paneli vëren në këtë drejtim se argumentet e z. Mustafa janë të llojit faktik. Z. Mustafa nuk pajtohet me përfundimet e nxjerra nga Trupi Gjykses, të konfirmuara më pas nga Paneli i Apelit, të cilat ia atribuojnë vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme anëtarëve të njësitit të z. Mustafa e jo forcave serbe që erdhën më vonë.⁸⁰ Në këtë aspekt, z. Mustafa pretendon se një supozim i, konkretisht rreziku për jetën e viktimës së vrasjes së paligjshme “nuk [u mbështet] nga asnjë provë, [ose][...] arsyetim se pse në fakt paraqisnin rrezik për jetën forcat serbe që po afroreshin”.⁸¹ Gjithashtu,

⁷⁵ Aktgjykimi i Apelit, para. 345-349.

⁷⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 347.

⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 348.

⁷⁸ Aktgjykimi i Apelit, para. 349.

⁷⁹ Aktgjykimi i Apelit, para. 350.

⁸⁰ Kërkesa, para. 91.

⁸¹ Kërkesa, para. 96.

z. Mustafa pretendon se as Trupi Gjykues, as Paneli i Apelit “nuk përcaktuan se kur iu afruan në fakt forcat serbe vendit ku ndodhej viktimja e vrasjes së paligjshme” dhe “nuk pati konstatime” nëse këto forca hynë faktikisht në atë vend apo qëndruan larg tij.⁸²

55. Paneli thekson se z. Mustafa kundërshton në veçanti se elementet e identifikuar nga Paneli i Apelit⁸³ lidhur me ndërhyrjen nga pala e tretë, nuk janë mbështetur me prova.⁸⁴ Megjithatë, Paneli thekson se Paneli i Apelit i analizoi këto elemente në mënyrën më të favorshme për z. Mustafa, me qëllim që të vlerësonte nëse ndërhyrja nga pala e tretë do të kishte ndërprerë zinxhirin e shkakësisë.⁸⁵ Rrjedhimisht, edhe në qoftë se këto elemente do të ishin vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm, kjo nuk do të kishte ndryshuar rezultatin e arsyetimit të Panelit të Apelit.

56. Sidoqoftë, Paneli vë në dukje se Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykues me të drejtë arriti në përfundimin se mund të ketë pasur më shumë se një shkak për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme dhe se keqtrajtimi dhe refuzimi i ndihmës mjekësore mund të çojnë në vdekjen e një personi.⁸⁶ Me fjalë të tjera, kundërshtimet e z. Mustafa në lidhje me origjinën e plumbit apo plumbave të gjetur në kufomën e viktimës së vrasjes së paligjshme janë jorelevante, pasi Trupi Gjykues dhe Paneli i Apelit arritën në përfundimin se viktimja e vrasjes së paligjshme do të kishte vdekur edhe pa plagët me armë zjarri, si pasojë e keqtrajtimit të tij nga forcat e BIA-s nën komandën e z. Mustafa, ose nga “lënia e viktimës së vrasjes së paligjshme në një situatë që mund të qëllohej nga forcat serbe që po afroreshin — duke e braktisur pa

⁸² Kërkesa, para. 97. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 105 (“nuk u vërtetua”), 106 (“nuk u bë vlerësimi i duhur”), 108 (“vrasja nuk u përcaktua”).

⁸³ Paneli i Apelit evidentoi këto tri elemente: “për të pasur pasojë për zinxhirin e shkakësisë të nisur nga sjellja fillestare, ngjarja e re ndërhyrëse nuk duhet të jetë e parashikueshme, ose nuk duhet të jetë pjesë e sferës fillestare të rrezikut që i përket të akuzuarit dhe duhet të krijojë rrezik krejtësisht të ri që është aq i fuqishëm sa që ta bëjë rrezikun fillestar të paqenësishëm”. *Shih* Aktgjykimin e Apelit, para. 347.

⁸⁴ Kërkesa, para. 95-96.

⁸⁵ *Shih* Aktgjykimin e Apelit, para. 347.

⁸⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 350-351.

mbrojtje në një gjendje në prag të vdekjes” dhe refuzimi i ndihmës mjekësore që iu bë kësaj viktime.⁸⁷

57. Bazuar në sa më lart, Paneli arrin në përfundimin se, ndonëse z. Mustafa parashtron se në Aktgjykimin e Panelit të Apelit nuk u dha arsyetim ligjor, në thelb argumenti i z. Mustafa bazohet në mospajtim faktik. Paneli rikujton se rregulla 193(3) e Rregullores dhe standardi i shqyrtimit përcaktojnë se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e një përcaktimi të gabuar ose të paplotë të fakteve lidhur me faktet e çështjes. Gjithashtu, Paneli rikujton se standardi i shqyrtimit kërkon që pretendimi për shkelje të ketë ndikim material në rezultatin e Aktgjykimit të Apelit. Paneli thekson se, edhe në qoftë se do të kishte konstatim mbi origjinën e plumbit apo të plumbave dhe pasojën e plagës apo plagëve me armë zjarri të gjetura në viktimën e vrasjes së paligjshme, kjo nuk do të kishte ndryshuar rezultatin e konstatimeve të Aktgjykimit apo të Aktgjykimit të Apelit në lidhje me përgjegjësinë penale të z. Mustafa. Në veçanti, Trupi Gjykses konstatoi, dhe Paneli i Apelit e konfirmoi, se keqtrajtimi i rëndë i viktimës së vrasjes së paligjshme dhe refuzimi i ndihmës mjekësore kësaj viktime i “atribuohen vetëm” z. Mustafa dhe vartësve të tij të BIA-s dhe se këto ishin shkaqe të konsiderueshme të vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.⁸⁸ Trupi Gjykses dhe Paneli i Apelit përcaktuan se, edhe në qoftë se do të ishte bërë konstatim në lidhje me një ndërhyrje nga pala e tretë, kjo nuk do ta kishte ndërprerë zinxhirin e shkakësisë që çoi në vdekjen e viktimës.⁸⁹ Rrjedhimisht, Arsyeja 4 e z. Mustafa hidhet poshtë menjëherë.

⁸⁷ Aktgjykimi, para. 638; Aktgjykimi i Apelit, para. 348, 350- 351,353, 394.

⁸⁸ Aktgjykimi, para. 625.

⁸⁹ Aktgjykimi, para. 638; Aktgjykimi i Apelit, para. 348.

C. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 44(2) TË LIGJIT, NENIT 33(2) TË KUSHTETUTËS DHE
NENIT 7 TË KEDNJ-SË (ARSYEJA 2)

1. Parashtrimet

58. Z. Mustafa parashtron se Paneli i Apelit “interpretoi dhe zbatoi gabim nenin 44(2) të Ligjit”.⁹⁰ Konkretisht, z. Mustafa pretendon se Paneli i Apelit e kuptoi gabim shprehjen “marrin parasysh” se u referohet faktorëve dhe jo detyrimit për të zbatuar listën e renditur pas shprehjes “marrin parasysh” si “ligje që përcaktojnë shkallëzimet e dënimeve në lidhje me krimet”.⁹¹ Sipas z. Mustafa, përmendja e legjislacionit të Kosovës në nenin 44(2)(a) të Ligjit “sugjeron se nuk ai mund të cilësohet thjesht si ‘faktor’”.⁹² Z. Mustafa pretendon se faktorët “janë të një lloji tjetër, zakonisht të papërcaktuar dhe trajtohen sipas rrethanave dhe veçorive të një çështjeje”.⁹³

59. ZPS-ja parashtron se argumentet e z. Mustafa në lidhje me efektin detyrues të legjislacionit të Kosovës kur bëhet fjalë për dënimin e tij “shpërfillin faktin se neni 44(2) [i Ligjit] kërkon që paneli të ‘marrë parasysh’ dhe jo të ‘zbatojë’ shkallëzimet e dënimeve sipas legjislacionit të Kosovës”.⁹⁴

60. Z. Mustafa kundërpërgjigjet se ZPS-ja e kupton gabim nenin 44(2) të Ligjit duke u shprehur se panelet duhet të “marrin parasysh” në vend që të “zbatojnë” shkallëzimet e dënimeve sipas ligjit të Kosovës.⁹⁵ Z. Mustafa pretendon se neni 44(2) i Ligjit e ngarkon Panelin e Apelit me detyrimin për të zbatuar legjislacionin e Kosovës, në vend që ta cilësojë atë faktor që duhet të merret parasysh.⁹⁶

⁹⁰ Kërkesa, para. 51. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 56-63; Kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, para. 23.

⁹¹ Kërkesa, para. 52-54. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 35.

⁹² Kërkesa, para. 54.

⁹³ Kërkesa, para. 55.

⁹⁴ Përgjigja e ZPS-së, para. 19. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e ZPS-së, para. 13-14, 20-21.

⁹⁵ Kundërpërgjigja ndaj ZPS-së, para. 24-27.

⁹⁶ Kundërpërgjigja ndaj ZPS-së, para. 28-30. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, para. 31-32.

2. Vlerësimi i Panelit

61. Paneli vë në dukje se z. Mustafa nuk shpjegon nëse parashtrimet e tij në kuadër të kësaj Arsyeje mund të cilësohen si pretendime për shkelje të së drejtës penale ose shkeljen e të konsiderueshme e procedurave. Z. Mustafa thjesht përmend se interpretimi në të cilin u bazuan Trupi Gjykes dhe Paneli i Apelit shkel të drejtat kushtetuese të tij.⁹⁷

62. Gjithashtu, Paneli thekson se z. Mustafa thjesht nuk pajtohet me kuptimin e zakonshëm që u atribuohet nga gjykatat e shkallës më të ulët termave në nenin 44(2) të Ligjit⁹⁸ pa e mbështetur me fakte pretendimin e tij se elementet e renditura në nenin 44(2) duhet të interpretohen si diçka tjetër dhe jo si “faktorë”. Në dallim nga kjo, Paneli i Apelit u angazhua gjerësisht me argumentet e z. Mustafa në këtë aspekt dhe u bazua në jurisprudencë për ta mbështetur më tej arsyetimin e vet.⁹⁹ Paneli pajtohet me kuptimin e drejtpërdrejtë që Paneli i Apelit i atribuoi vlerësimi që duhet t’u bëhet faktorëve të renditur në nenin 44(2) të Ligjit.¹⁰⁰

63. Bazuar në sa më lart, Paneli i Gjykatës Supreme hedh poshtë Arsyen 2.

D. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 44(2) TË LIGJIT DHE NENEVE 22, 33(2) DHE (4) TË KUSHTETUTËS (ARSYET 1 DHE 3)

1. Parashtrimet

64. Z. Mustafa argumenton se interpretimi që i bën Paneli i Apelit konceptit *lex mitior* “është shumë i kufizuar dhe për rrjedhojë, i gabuar” pasi fokusohet vetëm në veprën penale dhe jo në shkallëzimin e dënimit për atë veprë penale.¹⁰¹ Z. Mustafa pretendon se Dhomat e Specializuara kanë detyrimin të zbatojnë legjislacionin e

⁹⁷ *Shih* Kërkesën, para. 63-64.

⁹⁸ *Shih* nenin 31(1) të Konventës Evropiane për të Drejtën e Traktateve.

⁹⁹ Aktgjykimi i Apelit, para. 466; Aktgjykimi i Apelit, poshtëshënimi 1269.

¹⁰⁰ *Shih* Aktgjykimi i Apelit, para. 466.

¹⁰¹ Kërkesa, para. 25-26. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 28-29, 48.

Kosovës sikurse përcaktohet në nenin 44(2)(a) dhe (b) të Ligjit së bashku me nenin 33(2) të Kushtetutës së Kosovës dhe, për rrjedhojë, kanë detyrimin të zbatojnë shkallëzimet e dënimeve në Kosovë.¹⁰² Në lidhje me këtë z. Mustafa argumenton se Dhomat e Specializuara janë gjykatë vendore dhe jo ndërkombëtare.¹⁰³ Z. Mustafa parashtron se gjykatat e shkallës më të ulët gabuan që nuk respektojnë parimin *lex mitior* dhe nuk zbatuan shkallëzimet e dënimeve të përcaktuara në nenet 38 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1976 (“Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976”), i cili, argumenton z. Mustafa, përcakton shkallëzimin e dënimit për krime lufte nga 5 deri në 15 vjet burgim.¹⁰⁴

65. Z. Mustafa pretendon se zbatimi i *lex mitior* dhe, për rrjedhojë, i Kodit Penal të RSFJ-së i vitit 1976, është gjithashtu në përputhje me nenin 7 të KEDNJ-së.¹⁰⁵ Në mënyrë të ngjashme, z. Mustafa parashtron se neni 3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës i vitit 2019 (“Kodi Penal i Kosovës i vitit 2019”)¹⁰⁶ dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës i vitit 2012 (“Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012”),¹⁰⁷ si edhe neni 2 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës i vitit 2003 (“Kodi i Përkohshëm Penali i Kosovës i vitit 2003”)¹⁰⁸ gjithashtu përcaktojnë se duhet të zbatohet parimi *lex mitior* në shkallëzimin e dënimit për dënimin e tij për krime lufte.¹⁰⁹ Z. Mustafa pretendon se shkelet edhe parimi *nulla poena sine lege* shkelet kur nuk ka bazë ligjore që një gjykatë të japë dënim më të rëndë.¹¹⁰

66. Z. Mustafa parashtron se, edhe nëse pranohet që shkallëzimet e dënimeve në Kosovë duhet të konsiderohen “faktorë”, ato gjithsesi nuk u morën parasysh nga

¹⁰² Kërkesa, para. 28-34, 41, 46-47. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 42, 83-84; Kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, para. 12.

¹⁰³ Kërkesa, para. 30-31.

¹⁰⁴ Kërkesa, para. 34, 37-38. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 71.

¹⁰⁵ Kërkesa, para. 34, 37, 40, 43-45. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, para. 13-14.

¹⁰⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, Gazeta Zyrtare nr. 2, 14 janar 2019.

¹⁰⁷ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 04/L-082, Gazeta Zyrtare nr. 19, 13 korrik 2012.

¹⁰⁸ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, UNMIK/REG/2003/25, 6 korrik 2003.

¹⁰⁹ Kërkesa, para. 39. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, para. 13-14.

¹¹⁰ Kërkesa, para. 44. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 45; Kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, para. 19.

Paneli i Apelit gjatë përcaktimit të shkallëzimit të dënimit lidhur me fajësinë e tij për krime lufte, në shkelje të nenit 44(2) të Ligjit dhe nenit 33(2) dhe (4) të Kushtetutës.¹¹¹ Z. Mustafa pretendon se në analizimin e jurisprudencës ndërkombëtare dhe vendore mbi shkallëzimet e dënimeve lidhur me fajësinë për krime lufte, Paneli i Apelit arriti në përfundimin e gabuar se shkallëzimet e dënimeve të zbatueshme ishin midis 18 dhe 35 vjet.¹¹² Sipas z. Mustafa, Paneli i Apelit duhej të mbështetej në çështjet gjyqësore të cituara të Kosovës, pasi ato janë më të ngjashme me çështjen e tij dhe në to shpesh është zbatuar Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 për këtë aspekt, gjithmonë duke mbajtur parasysh Rregulloren nr. 1999/24 të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ("Rregullorja 1999/24 e UNMIK-ut"), që anuloi dënimin me vdekje.¹¹³

67. Z. Mustafa kërkon që Paneli t'i miratojë këto Arsye dhe të zbatojë rregullën 194(1) të Rregullores.¹¹⁴

68. Në kundërshtim me pretendimin e z. Mustafa, ZPS-ja përgjigjet se parimi *lex mitior* i përcaktuar në nenin 44(2) të Ligjit zbatohet për ligjet që kanë fuqi detyruese për Dhomat e Specializuara.¹¹⁵ ZPS-ja parashton se Paneli i Apelit me të drejtë arriti në përfundimin se dispozitat ligjore të zbatueshme për krimet për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor bazohen në të drejtën zakonore ndërkombëtare.¹¹⁶ Sipas ZPS-së, rrjedhimisht, neni 44(2) i Ligjit nuk u imponon Dhomave të Specializuara detyrimin për të zbatuar shkallëzime dënimesh për krime ndërkombëtare të përcaktuara në kodet penale të Kosovës.¹¹⁷ ZPS-ja parashton se përmendja e parimit *lex mitior* prej z. Mustafa, si një parim që garantohet nga Kushtetuta e Kosovës dhe KEDNJ-ja, nuk e

¹¹¹ Kërkesa, para. 82-86. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 69-70.

¹¹² Kërkesa, para. 73-75.

¹¹³ Kërkesa, para. 76. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 77-81; Kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, para. 36-38; Rregulloren nr. 1999/24 të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK/REG/1999/24, 12 dhjetor 1999.

¹¹⁴ Kërkesa, para. 49, 87.

¹¹⁵ Përgjigjja e ZPS-së, para. 11.

¹¹⁶ Përgjigjja e ZPS-së, para. 11. *Shih gjithashtu* Përgjigjen e ZPS-së, para. 12, 17.

¹¹⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 12-14.

ndryshon faktin se ky parim zbatohet vetëm për ligjet që kanë fuqi detyruese për Dhomat e Specializuara.¹¹⁸

69. Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se z. Mustafa nuk shpjegon se çfarë informacioni shtesë “përveç shkallëzimeve të dënimeve sipas legjislacionit dhe jurisprudencës relevante” duhej të kishte marrë parasysh Paneli i Apelit.¹¹⁹ ZPS-ja parashtron se pretendimi i z. Mustafa se Paneli i Apelit duhej të kishte marrë parasysh çështjet gjyqësore të Kosovës pasi kishin më shumë ngjashmëri me çështjen e tij, përfshirë çështjet gjyqësore të evidentuara nga z. Mustafa, është argument faktik dhe duhet të hidhet poshtë menjëherë.¹²⁰

70. Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se z. Mustafa nuk paraqiti parashtrime relevante mbi këto çështje gjyqësore ose çështje të tjera gjyqësore të krahasueshme gjatë gjykimit ose seancave të apelit, ndonëse iu kërkua shprehimisht ta bënte këtë. Sipas ZPS-së, rrjedhimisht, “parashtrimet *de novo* në Gjykatën Supreme” të z. Mustafa duhet të hidhen poshtë menjëherë.¹²¹ Së fundi, ZPS-ja parashtron se z. Mustafa thjesht shpreh mospajtimin e tij me përfundimet e Panelit të Apelit pa evidentuar ndonjë shkelje të ligjit dhe për rrjedhojë, duhet të hidhet poshtë menjëherë.¹²²

71. Mbrojtësja e Viktimave thekson se, ndonëse nuk është thënë shprehimisht, duket se z. Mustafa argumenton shkelje të së drejtës penale.¹²³ Në këtë aspekt, Mbrojtësja e Viktimave parashtron se Paneli i Gjykatës Supreme ka përcaktuar një listë shteruese të veprave që mund të cilësohen si shkelje e së drejtës penale në mënyrë që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të pranohet dhe pretendon se z. Mustafa nuk specifikoi se çfarë ishte shkelur nga kjo listë.¹²⁴ Sipas Mbrojtëses së Viktimave, edhe

¹¹⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 15.

¹¹⁹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 24.

¹²⁰ Përgjigjja e ZPS-së, para. 25.

¹²¹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 26.

¹²² Përgjigjja e ZPS-së, para. 27.

¹²³ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 5.

¹²⁴ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 6-7.

vetëm mbi këtë bazë, parashtrimet e z. Mustafa duhet të hidhen poshtë.¹²⁵

72. Gjithashtu, Mbrojtësja e Viktimave pretendon se z. Mustafa citon në mënyrë përzgjedhëse konstatimet e Panelit të Apelit lidhur me parimin *lex mitior* dhe se nuk pranon konstatimet kryesore të Panelit të Apelit në lidhje me ligjin që Dhomat e Specializuara janë të detyruara të zbatojnë.¹²⁶ Mbrojtësja e Viktimave parashtron se konstatimet e Panelit të Apelit në këtë aspekt nuk bien ndesh me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ"), në të cilën mbështetet z. Mustafa.¹²⁷ Gjithashtu, Mbrojtësja e Viktimave argumenton se z. Mustafa i paraqet në mënyrë të pasaktë shkallëzimet e dënimeve të përcaktuara në Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976 dhe parashtron se në fakt nenet 38 dhe 142 të këtij Kodi përcaktojnë një shkallëzim dënimesh nga pesë deri në 20 vjet.¹²⁸

73. Z. Mustafa kundërpërgjigjet se neni 44(2) i Ligjit u imponon paneleve detyrimin e zbatimit të parimit *lex mitior* dhe parashtron se ky parim nuk mund të kufizohet nga Ligji.¹²⁹ Z. Mustafa gjithashtu parashtron se KEDNJ-ja është direkt e zbatueshme nëpërmjet nenit 22 të Kushtetutës dhe, në përputhje me të, jurisprudenca e GJEDNJ-së e bën të qartë se një gjykatë nuk mund të shqiptojë dënim më të rëndë në shkelje të parimit *lex mitior* të mbështetur nga GJEDNJ-ja.¹³⁰ Së fundi, z. Mustafa pretendon se ka evidentuar qartësisht shkeljet e paraqitura në këto arsye.¹³¹

2. Vlerësimi i Panelit

74. Paneli vëren se z. Mustafa nuk përcakton nëse arsyet janë për shkelje të konsiderueshme të procedurave apo shkelje të së drejtës penale. Gjithsesi, sipas Panelit argumentet e z. Mustafa janë për shkelje të së drejtës penale, në veçanti në

¹²⁵ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 7.

¹²⁶ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 9.

¹²⁷ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 10.

¹²⁸ Përgjigjja e Mbrojtëses së Viktimave, para. 11.

¹²⁹ Kundërpërgjigjja ndaj ZPS-së, para. 14-17.

¹³⁰ Kundërpërgjigjja ndaj ZPS-së, para. 18-21.

¹³¹ Kundërpërgjigjja ndaj ZPS-së, para. 4, 40.

lidhje me marrjen e vendimit për dënim, ku pretendohet se panelet e shkallës më të ulët kanë keqpërdorur kompetencën e tyre lidhur me nenin 44(2) të Ligjit. Rrjedhimisht, Paneli i konstaton të pranueshme Arsyet 1 dhe 3 të z. Mustafa dhe do të shqyrtojë themelësinë e tyre.

75. Bazuar në arsyet e përcaktuara në vijim, Paneli konstaton se Paneli i Apelit duhej: (i) të kishte përcaktuar legjislacionin përkatës në Kosovë në përputhje me nenin 44(2)(b) të Ligjit dhe sikurse kërkohet nga parimi *lex mitior* (Arsyeja 1); (ii) të kishte përcaktuar mbi atë bazë shkallëzimin më të butë të dënimit që duhet të merrej parasysh në rastin e z. Mustafa dhe, në këtë kontekst, se si arriti në uljen me katër vjet të dënimit të z. Mustafa (Arsyeja 3). Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Paneli i Apelit ka shkelur të drejtën penale brenda kuptimit të nenit 48(7) të Ligjit.

76. Fillimisht, Paneli u referohet argumenteve të z. Mustafa në lidhje me dispozitat ligjore përkatëse në kontekstin e llojit të Dhomave të Specializuara si gjykatë vendore ose ndërkombëtare. Sikurse ka përcaktuar më parë Paneli i Apelit: “nuk është kategorizimi i Dhomave të Specializuara si një lloj i veçantë gjykate ai që përcakton të drejtën e zbatueshme, por vetë Ligji”, dhe se lloji i gjykatës “nuk përcakton kornizën ligjore”.¹³²

77. Në lidhje me të drejtën e zbatueshme, Paneli rikujton se sipas nenit 162(1) të Kushtetutës “organizimi, funksioni dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuar [...] rregullohen me këtë nen” të Kushtetutës, si edhe me ligj të veçantë, konkretisht Ligji.

78. Neni 3(2) i Ligjit gjithashtu përcakton se “Dhomat e Specializuara gjykojnë dhe funksionojnë në përputhje me” Kushtetutën e Kosovës, këtë Ligj si *lex specialis*, si edhe dispozita të tjera të legjislacionit të Kosovës që janë përfshirë shprehimisht në Ligj dhe zbatohen nga Ligji, të drejtën zakonore ndërkombëtare (së cilës i është dhënë

¹³² KSC-BC-2020-04/IA002/F00010, Vendim mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Mocionin që Ngre Kundërshtime lidhur me Themelimin dhe Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 11 shkurt 2022, para. 19.

përparësi kundrejt ligjeve vendore dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

79. Neni 12 i Ligjit me titull “Ligji i zbatueshëm” më tej saktëson se “Dhomat e Specializuara zbatojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe ligjin penal të zbatueshëm në Kosovë përderisa ai është në përputhje me të drejtën zakonore ndërkombëtare, që ka qenë i zbatueshëm në kohën që janë kryer krimet”. Rrjedhimisht, parashtrimet e z. Mustafa në lidhje me llojin e Dhomave të Specializuara dhe ligjin që duhet të zbatohet në këtë çështje janë të pabazuara dhe për rrjedhojë, hidhen poshtë.

80. Në vijim, Paneli do të trajtojë parashtrimet e z. Mustafa në lidhje me parimin *lex mitior* dhe zbatimin e këtij parimi në dënimin e tij në kontekstin e nenit 44(2) të Ligjit.

81. Paneli rikujton nenin 44(2)(a)-(c) i Ligjit, i cili kërkon që në përcaktimin e dënimit që do të shqiptojë ndaj një personi të shpallur fajtor për një krim ndërkombëtar sipas këtij Ligji, Dhomat e Specializuara marrin parasysh: (i) shkallëzimin e dënimit për atë krim, të përcaktuar sipas legjislacionit të Kosovës në kohën e kryerjes së krimit; (ii) çfarëdo shkallëzimi të dënimit më të butë të mëvonshëm për atë krim, të përcaktuar në legjislacionin e Kosovës; dhe (iii) konventat e ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare të përfshira në nenet 22(2), 22(3) dhe 33(1) të Kushtetutës dhe shkallën në të cilën ndëshkimi i një veprimi ose mosveprimi që cilësohej kriminal sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara, do të cenohej me zbatimin e nenit 44(2)(a) dhe (b) të Ligjit.

82. Paneli konkretisht thekson nenin 33(2) të Kushtetutës, i cili përcakton se “dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale”. Neni 33(4) gjithashtu përcakton se “dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i

aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.” Rrjedhimisht, parimi *lex mitior* është i zbatueshëm në Dhomat e Specializuara përmes neneve 33 dhe 162(2) të Kushtetutës së bashku me nenet 3(2)(a) dhe 44(2)(b) të Ligjit.

83. Parimi *lex mitior* përcaktohet edhe në nenin 7(1) të KEDNJ-së dhe është zbatuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së,¹³³ që ka fuqi detyruese për Dhomat e Specializuara në bazë të nenit 3(2)(e) të Ligjit dhe neneve 22(2), 53 dhe 162(2) të Kushtetutës.

84. Paneli vë në dukje se z. Mustafa kundërshton përkufizimin e parimit *lex mitior* të përcaktuar nga Paneli i Apelit,¹³⁴ përfshirë se ligji lidhur me përcaktimin e dënimit duhet të ketë fuqi detyruese për Dhomat e Specializuara. Megjithatë, ai argumenton se Trupi Gjykues dhe Paneli i Apelit gabuan që konstatuan se Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976, i ndryshuar më vonë me Rregulloren 1999/24 të UMNİK-ut, nuk ka fuqi detyruese mbi Dhomat e Specializuara dhe se ai duhej të ishte zbatuar nga gjykatat e shkallës më të ulët sipas nenit 33(4) të Kushtetutës dhe nenit 44(2) të Ligjit.¹³⁵

85. Paneli vëren se kur Paneli i Apelit trajtoi argumentet e z. Mustafa, fillimisht theksoi se në nenin 14(1) të Ligjit krimet e luftës përkufizohen sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare.¹³⁶ Për rrjedhojë, Paneli i Apelit gjithashtu vuri re se “sipas nenit 3(2)(b) dhe (c) të Ligjit, Dhomat e Specializuara gjykojnë në përputhje me, ndër të tjera, Ligjin si *lex specialis* dhe dispozita të tjera të legjislacionit të Kosovës që janë përfshirë shprehimisht në Ligj dhe zbatohen nga Ligji”.¹³⁷ Paneli i Apelit theksoi se neni 3(4) i Ligjit përcakton se “çdo ligj ose rregullore tjetër e Kosovës që nuk është përfshirë shprehimisht në Ligj, nuk zbatohet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara”.¹³⁸

86. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstatoi se duke qenë se këto ligje shtetërore nuk

¹³³ *Shih, p.sh.* ECtHR, *Ruban v. Ukraine*, no. 8927/11, Judgment, 28 November 2016, para. 37, që citon *Scop.ola v. Italy* (No 2), no. 10249/03, Judgment, 17 September 2009, para. 109.

¹³⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 465; Kërkesa, para. 25, 28.

¹³⁵ Kërkesa, para. 25-28, 32-34, 38-44, 82-84.

¹³⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 469.

¹³⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 469.

¹³⁸ Aktgjykimi i Apelit, para. 469.

“përfshihen dhe zbatohen shprehimisht nga Ligji, Dhomat e Specializuara nuk janë të detyruara të marrin parasysh ligjet e ndryshme shtetërore për krime të luftës për të përmbushur parimin *lex mitior* sipas Kushtetutës së Kosovës”.¹³⁹ Për rrjedhojë, Paneli i Apelit nuk evidentoi shkallëzimin më të butë të dënimit në çështjen e z. Mustafa.

87. Paneli konstaton se Paneli i Apelit gaboi kur konstatoi se Dhomat e Specializuara nuk janë të detyruara të marrin parasysh ligjet e ndryshme shtetërore për krime të luftës për të përmbushur parimin *lex mitior* sipas Kushtetutës. Paneli thekson se ndonëse neni 44(2) i Ligjit nuk u referohet ligjeve konkrete shtetërore, ai kërkon shprehimisht që Dhomat e Specializuara të evidentojnë shkallëzimet e zbatueshme të dënimit të përcaktuara në legjislacionin e Kosovës në përputhje me nënparagrafët (a) dhe (b). Në këtë aspekt, Dhomat e Specializuara janë të detyruara të marrin në konsideratë se cili prej shkallëzimeve përkatëse të dënimit sipas legjislacionit të Kosovës është më i butë, në përputhje me parimin *lex mitior*. Më pas, paneli që shqipton dënimin duhet ta marrë parasysh shkallëzimin në fjalë kur përcakton dënimin me burgim.

88. Me fjalë të tjera, Dhomat e Specializuara janë të detyruara që fillimisht të shqyrtojnë legjislacionin përkatës të Kosovës, të evidentojnë shkallëzimet e dënimeve të përcaktuara në të dhe të përcaktojnë shkallëzimin më të butë të dënimit në përputhje me parimin *lex mitior*. Pasi të kenë evidentuar shkallëzimet e dënimeve, Dhomat e Specializuara e marrin parasysh këtë shkallëzim kur përcaktojnë dënimin që do të japin. Paneli është i mendimit se ndonëse panelet kanë kompetencë diskrecionale në përcaktimin e dënimit, shprehja “marrin parasysh”¹⁴⁰ duhet të interpretohet në përputhje me parimin *lex mitior* të përcaktuar në nenin 33(4) të Kushtetutës, nenin 7(1) të KEDNJ-së dhe të pasqyruar në nenin 44(2)(b) të Ligjit.

89. Paneli thekson se ndonëse Paneli i Apelit konstatoi se Dhomat e Specializuara

¹³⁹ Aktgjykimi i Apelit, para. 469. *Shih gjithashtu* Aktgjykimin e Apelit, para. 466-468.

¹⁴⁰ Theksimi i shtuar.

nuk janë të detyruara të marrin në konsideratë legjislacionet shtetërore kur përcaktojnë dënimin me burgim, ai megjithatë i analizoi përcaktimet e Trupit Gjykses në përputhje me nenin 44(2)(a) dhe (b) të Ligjit.¹⁴¹

90. Konkretisht, Paneli i Apelit konstatoi se Trupi Gjykses iu referua saktësisht neneve 38 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976 si dispozitat ligjore të zbatueshme në përputhje me nenin 44(2)(a) të Ligjit.¹⁴² Gjithashtu, Paneli i Apelit theksoi se anulimi i dënimit me vdekje me Rregulloren 1999/24 të UMNİK-ut, pa specifikuar një alternativë ndaj tij, rezultoi që shkallëzimi i dënimeve që nga ai moment (në përputhje me nenin 44(2)(b) të Ligjit) të ishte prej pesë deri në 15 vjet burgim.¹⁴³

91. Më pas, Paneli i Apelit vazhdoi analizimin e konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me shkallëzimet e tjera të dënimeve më të buta të përcaktuara më vonë.¹⁴⁴ Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vuri në dukje llojin ndërkombëtar të krimeve të përcaktuara në nenin 14 të Ligjit.¹⁴⁵ Megjithatë, Paneli i Apelit nuk nxori ndonjë përfundim prej këtij neni, as nuk përcaktoi se si ndikoi ai në zbatueshmërinë e Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976 dhe Rregullores së UMNİK-ut që lidhet me të në çështjen e z. Mustafa.¹⁴⁶ Në fakt, Paneli i Apelit vazhdoi menjëherë analizimin e jurisprudencës ndërkombëtare dhe vendore.¹⁴⁷

92. Paneli është i mendimit se Paneli i Apelit gaboi kur nuk përcaktoi në fillim shkallëzimin përfundimtar të dënimit në çështjen *Mustafa* përpara se të përcaktonte dënimin. Rrjedhimisht, Paneli do të vazhdojë me përcaktimin e dispozitave ligjore përkatëse dhe shkallëzimin e dënimeve që duhet të merren parasysh në rrethanat

¹⁴¹ Aktgjykimi i Apelit, para. 472-475.

¹⁴² Aktgjykimi i Apelit, para. 473.

¹⁴³ Aktgjykimi i Apelit, para. 473.

¹⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 474-479.

¹⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit, para. 470.

¹⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 470.

¹⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 478.

aktuale.

93. Në përcaktimin e dispozitave ligjore përkatëse, Paneli rikujton dallimin që bën Ligji ndërmjet krimeve të luftës sipas së drejtës ndërkombëtare (neni 14) dhe krimeve të tjera sipas së drejtës së Kosovës (neni 15). Kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me vrasje të paligjshme, torturë dhe ndalim arbitrar si krime lufte sipas së drejtës ndërkombëtare sipas nenit 14 të Ligjit, në dallim nga vrasja e paligjshme sipas legjislacioneve shtetërore të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit. Vlen të theksohet se neni 15 i Ligjit i referohet Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976, ndryshuar me Rregulloren 2000/59 të UNMIK-ut, si edhe me dispozita të tjera ligjore të Kosovës,¹⁴⁸ ndërsa neni 14 i Ligjit, në bazë të të cilit z. Mustafa u shpall fajtor, i referohet vetëm së drejtës zakonore ndërkombëtare. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se ka dallim juridikisht thelbësor në krimet materiale të përmendura në nenin 14 dhe nenin 15(1)(a) të Ligjit.

94. Ky dallim është gjithashtu i dukshëm në krimet materiale shtesë në nenin 14 të Ligjit krahasuar me krimet materiale të renditura në nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976. Edhe nëse Paneli do të pranonte se shkallëzimi i dënimeve në Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976 duhet të merret parasysh në përputhje me nenin 44(2)(a) të Ligjit, sikurse pretendon z. Mustafa, kjo do të thotë se shkallëzimi i dënimeve në Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976 do të ishte i zbatueshëm vetëm për *disa* por jo për *të gjitha* krimet që përmenden në nenin 14 të Ligjit. Rrjedhimisht, shkallëzimet e dënimeve që duhet të evidentohen brenda kuptimit të nenit 44(2)(b) të Ligjit dhe evidentimi i shkallëzimit më të butë të dënimeve, do të ndryshonin në varësi të faktit nëse krimet e luftës të paraqitura në Aktakuzë sipas nenit 14 të Ligjit pasqyrohen edhe në Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976.

95. Dallimi midis krimeve të luftës sipas nenit 14 të Ligjit dhe krimeve të tjera sipas legjislacionit të Kosovës, në përputhje me nenin 15 të Ligjit, gjendet edhe në nenin 16

¹⁴⁸ *Shih* nenin 15(1), 15(1)(a) dhe (b), 15(2) të Ligjit dhe referencat në dispozitat përkatëse të legjislacionit të Kosovës në të.

të Ligjit, i cili përcakton forma të ndryshme të përgjegjesisë penale individuale për krimet ndërkombëtare sipas nenit 16(1) të Ligjit, kundrejt krimeve vendore të përcaktuara në nenin 16(2) të Ligjit. Në këtë aspekt Paneli rikujton se z. Mustafa u shpall fajtor për krime lufte në bazë të formës së përgjegjesisë penale ndërkombëtare për krime ndërkombëtare, konkretisht në bazë të nenit 16(1)(a) i Ligjit.¹⁴⁹

96. Më konkretisht, në lidhje me “Dënimet” në nenin 44 të Ligjit, Ligji bën dallim midis krimeve ndërkombëtare dhe krimeve vendore kur shqyrton dënimin që do të shqiptohet. Neni 44(2) i Ligjit i referohet “personit të shpallur fajtor për ndonjë krim ndërkombëtar sipas këtij Ligji”, ndërsa neni 44(3) i referohet “personit të shpallur fajtor për ndonjë krim vendor sipas nenit 15(1)”. Gjithashtu, neni 44(2)(c) i Ligjit që përcakton se “ndëshkimi i veprimeve ose mosveprimeve të cilat ishin kriminale sipas parimeve të përgjithshme të ligjit të njohura nga kombet e qytetëruara” do të paragjykohej me zbatimin e nenit 44(2)(a) dhe (b) të Ligjit. Ndryshe nga kjo, neni 44(3) i Ligjit, që lidhet me krimet vendore sipas nenit 15(1) të Ligjit, nuk e përfshin kushtin e lartpërmendur në përcaktimin e shkallëzimit të dënimeve për krimet vendore.

97. Bazuar në sa më lart dhe në faktin se z. Mustafa u shpall fajtor dhe u dënua për krime lufte sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare në përputhje me nenin 14 të Ligjit, Kodi Penal i RSFJ-së i vitit 1976 dhe të gjitha ndryshimet që iu bënë atij nuk janë të zbatueshëm kur shqyrtohen shkallëzimet e dënimeve që duhet të merren parasysh në përputhje me nenin 44(2)(a) dhe (b) të Ligjit.¹⁵⁰

98. Për këtë arsye, çështja gjyqësore *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina* (*Maktouf dhe Damjanović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*) në GJEDNJ, në të cilën mbështetet z. Mustafa, nuk mund të merret për bazë në këtë çështje pasi bazohet në Kodin Penal të RSFJ-së të vitit 1976, ndryshuar me Rregulloren 1999/24 të UMNK-

¹⁴⁹ Aktgjykimi, para. 831; Aktgjykimi i Apelit, para. 484.

¹⁵⁰ Sidoqoftë, neni 142 i Kodit Penal të RSFJ-së i vitit 1976 përcaktonte si dënimin më të lartë që mund të jepet, dënimin me vdekje. Rrjedhimisht, ky nen nuk do të konsiderohet si *lex mitior*.

ut, që nuk është i zbatueshëm në çështjen e z. Mustafa.¹⁵¹

99. Paneli do të trajtojë në vijim përcaktimin e shkallëzimeve të dënimeve në çështjen e z. Mustafa. Paneli vë në dukje se e drejta zakonore ndërkombëtare nuk përcakton shkallëzime konkrete dënimesh për krime lufte.¹⁵² Për rrjedhojë, Dhomat e Specializuara duhet t'u referohen ligjeve të Kosovës që pasqyrojnë më së afërmi krimet ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 14 të Ligjit. Për këtë qëllim, Paneli do të shqyrtojë kodet penale përkatëse të Kosovës që përkojnë më së afërmi me krimet e luftës sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, sikurse përcaktohet në nenin 14(1)(c) të Ligjit, për të përcaktuar shkallëzimin më të butë të dënimit.

100. Paneli mori parasysh këto dispozita relevante të kodeve penale të Kosovës: (i) nenin 120(1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës të vitit 2003 (që përcakton, lexuar së bashku me nenin 37(2) të po atij Kodi, dënime me pesë deri në 40 vjet burgim, por jo dënim me burgim të përjetshëm); (ii) nenin 152(1) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2012 (që përcakton, lexuar së bashku me nenin 45(1) të po atij Kodi, dënime me pesë deri në 25 vjet burgim ose dënim me burgim të përjetshëm; dhe (iii) nenin 146(1) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019 (që përcakton, lexuar së bashku me nenin 42(1)-(2) të po atij Kodi, dënime me pesë deri në 25 vjet burgim ose dënim me burgim të përjetshëm, ku ky i fundit mund të zëvendësohet me një dënim deri në 35 vjet burgim).¹⁵³

101. Pasi shqyrtoi me kujdes Kodet Penale të Kosovës, Paneli konstaton se shkallëzimi i dënimeve në nenin 120(1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës të vitit 2003 është, teorikisht, më i ulët (pesë deri në 40 vjet), për shkak se nuk përmban dënimin me burgim të përjetshëm. Nga ana tjetër, kodet e viteve 2012 dhe 2019 përmbajnë shkallëzim më të butë dënimesh (pesë deri në 25 vjet), por dënimi më i lartë

¹⁵¹ *Shih* ECtHR, *Maktouf and Damjanović v. Bosnia and Herzegovina*, nos. 2312/08 and 34179/08, Judgment, 18 July 2013. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 40.

¹⁵² *Shih* Aktgjykimin e Apelit, para. 478.

¹⁵³ *Shih gjithashtu* Aktgjykimin e Apelit, poshtëshënimin 1292.

që mund të jepet përfshin mundësinë për dënim me burgim të përjetshëm. Paneli thekson se z. Mustafa u dënua me 22 vjet burgim,¹⁵⁴ d.m.th. jo me burgim të përjetshëm.

102. Krahasuar me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës të vitit 2003, i cili përmban si dënimin më të lartë 40 vjet burgim, Kodi Penal i Kosovës i vitit 2019 përmban shkallëzimin më të butë të dënimeve nga pesë deri në 25 vjet burgim.¹⁵⁵ Rrjedhimisht, neni 146(1) së bashku me nenin 42(1)-(2) të Kodit Penal të Kosovës përcaktojnë në çështjen e z. Mustafa shkallëzimin e dënimit më të butë që mund të jepet në përputhje me parimin *lex mitior*. Për rrjedhojë, Paneli konstaton se shkallëzimi i dënimit më të butë që duhet të merret parasysh në rastin e z. Mustafa në përputhje me nenin 44(2)(b) të Ligjit dhe nenin 146(1) së bashku me nenet 42(1) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, është ai me burgim nga pesë deri në 25 vjet.

103. Paneli do të shqyrtojë në vijim vendimin e Panelit të Apelit për uljen e dënimit të z. Mustafa me katër vjet (Arsyeja 3). Paneli vëren se Paneli i Apelit konstatoi se në jurisprudencën ndërkombëtare dhe atë vendore “dënimet e dhëna ishin më të shkurtra se dënimi i [z.] Mustafa [nga Trupi Gjykses]”.¹⁵⁶ Paneli i Apelit përcaktoi se Trupi Gjykses “tejkaloj kufijtë e diskrecionit të vet duke i dhënë z. Mustafa dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme”.¹⁵⁷ Megjithatë, Paneli i Apelit nuk arsyetoi se si arriti në uljen me katër vjet të dënimit të z. Mustafa.¹⁵⁸ Për shkak se nuk u përcaktua shkallëzimi i dënimit, është e pamundur të dihet dënimi maksimal që Paneli i Apelit pati parasysh.

¹⁵⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 480.

¹⁵⁵ Paneli vëren se Kodi Penal i Kosovës i vitit 2012 përfshin po ato shkallëzime dënimesh që përfshin Kodi Penal i Kosovës i vitit 2019. Në përputhje me qëllimin e nenit 64 të Ligjit, Paneli do të shikojë “legjislacionin pasardhës” që rregullon të njëjtën çështje lëndore, konkretisht, Kodi Penal i Kosovës i vitit 2019.

¹⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit, para. 479.

¹⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit, para. 479.

¹⁵⁸ *Shih* Aktgjykimin e Apelit, para. 476-480.

104. Në këtë aspekt, Paneli vë në dukje se Paneli i Apelit analizoi dhe krahasoi jurisprudencën ndërkombëtare me rrethanat e çështjes së z. Mustafa, konkretisht kuadrin e çështjeve, krimet, formën e përgjegjesisë penale dhe numrin e viktimave.¹⁵⁹ Paneli rikujton se neni 3(3) i Ligjit përcakton se gjykatësit mund të marrin parasysh, ndër të tjera, burime si jurisprudenca e tribunalëve dhe gjykatave ndërkombëtare, në përcaktimin e së drejtës ndërkombëtare zakonore në kohën e kryerjes së krimeve. Paneli pajtohet me konstatimin e Panelit të Apelit se ka “mospërputhje[e] ndërmjet dënimeve të z. Mustafa dhe dënimeve që analizoi [Trupi Gjykses]”.¹⁶⁰

105. Paneli gjithashtu shqyrtoi çështje gjyqësore që ishin të ngjashme me çështjen gjyqësore të z. Mustafa sa i përket kontekstit, krimeve bazë për të cilat ishin ngritur akuzat dhe numrit të viktimave, në të cilat ishin dhënë shumë më pak se 22 vjet burgim.¹⁶¹ Duke pasur parasysh sa më lart, Paneli gjithashtu pati të njëjtin mendim me Panelin e Apelit se dënimet për secilën vepër penale të dhëna nga Trupi Gjykses, veçanërisht për torturën dhe vrasjen e paligjshme, “i tejkaluan kufijtë e diskrecionit të

¹⁵⁹ *Shih* Aktgjykimin e Apelit, poshtëshënimin 1292. Paneli thekson konstatimet e Panelit të Apelit se jurisprudenca e Kosovës që kishte analizuar tregoi se ka dallim ndërmjet dënimeve të dhënë në ato çështje gjyqësore në krahasim me dënimin e vetëm të shqiptuar ndaj z. Mustafa nga Trupi Gjykses. *Shih* Aktgjykimin e Apelit, para. 479; Aktgjykimin, para. 829. Megjithatë, Paneli rikujton se çështjet gjyqësore të Kosovës lidhen me dënime të dhëna sipas Kodit Penal të RSFJ-së të vitit 1976. Gjithashtu, Paneli rikujton natyrën ndërkombëtare të krimeve të përcaktuara në nenin 14(1)(c) të Ligjit dhe moszbatueshmërinë e këtij Kodi.

¹⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit, para. 479.

¹⁶¹ *Shih* TPNJ, *Prokurori k. Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulovskit*, IT-04-82-T, Aktgjykim, 10 korrik 2008 (Z. Tarçulovski u dënua me 12 vjet burgim për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e vrasjeve të tri personave, shkatërrimin pa kriter të shtëpive ose pronave të tjera të dymbëdhjetë banorëve etnikë shqiptarë dhe për trajtimin mizor të 23), para. 608; *Prosecutor v. Dragan Zelenović*, IT-96-23/2-S, Sentencing Judgment, 4 April 2007, (Z. Zelenović u dënua me 15 vjet burgim për torturimin dhe përdhunimin e viktimave të shumëfishta si krim kundër njerëzimit), para. 70; *Prosecutor v. Ivica Rajić*, IT-95-12-S, Sentencing Judgment, 8 May 2006 (Z. Rajiq u dënua me 12 vjet burgim për vrasje të qëllimshme, trajtim çnjerëzor, marrje të pronës, shkatërtime masive të paarsyetuara me domosdoshmëri ushtarake dhe të kryera në mënyrë të paligjshme dhe pa kriter si shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës), para. 184; *Prokurori kundër Fatmir Limajt dhe të tjerëve*, IT-03-66-T, Aktgjykim, 30 nëntor 2005 (Z. Bala u dënua me 13 vjet burgim për pjesëmarrje personale në vrasjen e nëntë të burgosurve në një kamp burgimi), para. 742; *Prosecutor v. Mitar Vasiljević*, IT-98-32-A, Appeals Judgment, 25 February 2004 (Z. Vasiljeviq u dënua me 15 vjet burgim për ndihmimin dhe inkurajimin e krimeve të luftës kundër njerëzimit (vrasje të paligjshme dhe veprime çnjerëzore kundër pesë meshkujve), para. 182.

Trupit Gjykses, duke i dhënë z. Mustafa dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me një varg dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të ngjashme".¹⁶²

106. Paneli pranon se dënimi me 22 vjet burgim i dhënë nga Paneli i Apelit është brenda shkallëzimit të konstatuar nga pesë deri në 25 vjet dhe se panelet e shkallëve më të ulëta kanë kompetencë të gjerë diskrecionale në përcaktimin e dënimit me burgim. Paneli është gjithashtu i vetëdijshëm se panelet e shkallëve më të ulëta nuk janë të detyruara të zbatojnë shkallëzimin e përcaktuar të dënimit, por duhet ta marrin parasysh atë. Në fakt, faktorë të tjerë, ndër të cilët neni 44(2)(c) të Ligjit dhe rrethanat e veçanta të çështjes gjyqësore merren parasysh prej panelit në përcaktimin e dënimit të duhur me burgim.

107. Megjithatë, Paneli gjykon se Paneli i Apelit mund të kishte arritur në një përcaktim të ndryshëm të dënimit të z. Mustafa, në qoftë se do të kishte evidentuar saktë shkallëzimin e dënimit që duhet marrë parasysh, sipas të cilit, dënimi më i lartë që mund të jepet është me 25 vjet burgim.¹⁶³

108. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, Paneli miraton Arsyet 1 dhe 3 të Kërkesës. Paneli konstaton se Paneli i Apelit shkeli të drejtën penale: (i) duke mos evidentuar legjislacionin përkatës të Kosovës në përputhje me nenin 44(2)(b) të Ligjit dhe që kërkohet nga parimi *lex mitior*; (ii) duke mos evidentuar shkallëzimet e zbatueshme të dënimeve dhe (iii) arsyetuar si duhet se si arriti në uljen me katër vjet të dënimit të z. Mustafa.

109. Sipas rregullës 194(1) të Rregullores, "nëse paneli i Gjykatës Supreme miraton kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, në varësi të llojit të shkeljes, paneli: (a) modifikon aktvendimin ose aktgjykimin e kontestuar; (b) anulon tërësisht ose pjesërisht aktvendimin ose aktgjykimin e kontestuar dhe ia kthen çështjen për vendim

¹⁶² *Shih* Aktgjykimin e Apelit, para. 479.

¹⁶³ *Shih më lart*, para. 102.

të ri [...] panelit kompetent; ose(c) kufizohet vetëm në konfirmimin e ekzistencës së një shkeljeje ligjore”.

110. Paneli rikujton se rregulla 163 e Rregullores kërkon që të shqyrtohet një gamë e gjerë faktorësh në përcaktimin e dënimit. Duke pasur parasysh këtë, Paneli konstaton se Paneli i Apelit është në pozitë më të mirë për të përcaktuar dënimin e duhur për z. Mustafa, pasi e ka shqyrtuar me hollësi më parë dokumentacionin e çështjes dhe ka analizuar pikat e apelit të z. Mustafa në lidhje me të. Rrjedhimisht, Paneli anulon Aktgjykimin e Apelit në lidhje me dënimin e z. Mustafa në bazë të rregullës 194(1)(b) të Rregullores dhe ia kthen Aktgjykimin e Apelit Panelit të Apelit për të marrë një vendim të ri në lidhje me të. Paneli është i mendimit se Panelit të Apelit duhet t'i jepet mundësia për të rivlerësuar nëse dënimi me 22 vjet burgim i z. Mustafa është ende i arsyeshëm duke pasur parasysh shkallëzimin e dënimit të evidentuar dhe jurisprudencën e analizuar.

111. Në vlerësimin e ri të dënimit të z. Mustafa, Paneli i Apelit duhet të orientohet nga: (i) rregulla 163 e Rregullores; (ii) shkallëzimi i dënimit prej pesë deri në 25 vjet burgim i konstatuar nga ky Panel në çështjen e z. Mustafa; (iii) faktorët e përcaktuar nga Paneli i Apelit për dënimin;¹⁶⁴ (iv) jurisprudenca e analizuar nga Paneli i Apelit dhe nga ky Panel;¹⁶⁵ dhe (v) rrethanat konkrete të çështjes së z. Mustafa.

VI. VENDIM

112. Bazuar në këto arsye, Paneli i Gjykatës Supreme:

- a) **HEDH POSHTË** Arsyet 2 dhe 5;
- b) **HEDH POSHTË MENJËHERË** Arsyen 4;
- c) **MIRATON** Arsyet 1 dhe 3;

¹⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 478.

¹⁶⁵ *Shih më lart*, para. 104-105 dhe poshtëshënimin 161.

- d) **ANULON** Aktgjykimin e Apelit vetëm në lidhje me dënimin e z. Mustafa;

- e) **IA KTHEN** Aktgjykimin e Apelit Panelit të Apelit për të marrë vendim të ri në lidhje me dënimin e z. Mustafa në bazë të rregullës 194(1)(b) të Rregullores; dhe

- f) **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Mustafa ndërkohë që shqyrtohet marrja e një vendimi të ri të dënimit të tij nga Paneli i Gjykatës së Apelit.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova, Kryegjykatëse

E hënë, 29 korrik 2024

Në Hagë, Holandë